



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 11.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 09/04/2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X ose

"DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V dhe me adrese Lagjja "Nen Tereza", godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e larte monetar.

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-38895-02-21-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje materiale per mirembajtjen e rrugeve, trotuareve, shesheve, sistemit ujites dhe kullues ne Bashkine Lezhe".

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 03/03/2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 12, datë 10 Mars 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik "DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 39,485,595 (tridhjetë e nente milion e katerqind e tetedhjetë e pesë mijë e pesëqind e nentëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

- 2- Operatori Ekonomik "M U R A T I" Shpk, me Nuis J66702413V, me oferte ekonomike 39,880,430 (tridhjetë e nente milion e teteqind e tetedhjetë mijë e katerqind e tridhjetë leke) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

- 3- Operatori Ekonomik "ORNIAD" Shpk me Nuis J68423509H, me oferte ekonomike 41,307,287.35 (dyzet e një milion e treqind e shtatë mijë e dyqind e tetedhjetë e shtatë pike tridhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I. Operatori Ekonomik "ORNIAD" SH.P.K, me Nuis J68423509H,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.2.1 dhe 2.2.2, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *"2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës objekt prokurimi.*

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin vertetimin e xhiros dhe bilancet per vitet financiare 2021,2022,2023 sipas kerkeses se pikes 2.2.1 dhe 2.2.2 te DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje vertetim per xhiron vjetore apo balance duke mospermbushur kete kriter.

Se, dyti nuk ploteson kriterin 2.3.1, deri ne kriterin 2.3.7, te kushteve te vecanta te kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketyre kriterëve.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzojte oferten e OE “ORNIAD” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ORNIAD” SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V dhe me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe, se oferta e

paraqitur me vlerë totale prej 39,485,595 (tridhjetë e nente milion e katerqind e tetedhjetë e pese mije e pesëqind e nentedhjetë e pese) Lek pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU